



ISEE-HSP

Institute of Southeast Europe
for Health and Social Policy

Përmbledhje Politike

Financimi i Shëndetësisë dhe Mbrojtja Financiare në Kosovë

Mars 2026

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

336.1:614(496.51)

Përmbledhje Politike : financimi i Shëndetësisë dhe Mbrojtja Financiare në Kosovë /
përgatitur nga Agron Gashi ... [etj.]. - Prishtinë : Instituti i Evropës Juglindore për
Politika Shëndetësore dhe Sociale, 2026. - 44 f. ; 21 cm.

1. Gashi, Agron 2. Ukmata, Driton 3. Agani, Ferid 4. Tolaj, Ilir

ISBN 978-9951-9280-2-1

Shënim: Ky dokument është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze mbetet referenca zyrtare.

Përgatitur nga:

Dr. Agron Gashi, MSc Shëndet Publik, Drejtor Ekzekutiv, Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale (IEJL–PShS)

Dr. Driton Ukmata, MSc Menaxhim Shëndetësor

Me kontribute teknike dhe propozime strategjik:

Prof. Dr. Ferid Agani, Ish-Ministër i Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Prof. Dr. Ilir Tolaj, Ish-Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Lloj publikimi: Përmbledhje shkencore e pavarur (policy brief)**Audienca:** Vendimmarrës, profesionistë shëndetësorë, institucione, media, organizata ndërkombëtare dhe shoqëri civile**Data:** Mars 2026**Fokusi gjeografik:** Kosovë

Pozicionimi institucional dhe pavarësia

Ky dokument është përgatitur si një kontribut i pavarur dhe jopartiak për një dialog të bazuar në evidencë mbi reformën e financimit të shëndetësisë në Kosovë. Analiza bazohet në burime publike të dhënash, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë dokumente zyrtare, të dhëna nga anketat familjare, korniza ligjore, si dhe databaza të njohura ndërkombëtare, si ato të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe Bankës Botërore.

Interpretimet dhe përfundimet e paraqitura në këtë dokument nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e ndonjë institucioni qeveritar, agjencie donatore apo organizate ndërkombëtare, dhe nuk duhet të interpretohen si qëndrime zyrtare të ndonjë entiteti të lidhur.

Ky dokument analizon karakteristikat strukturore të sistemit të financimit të shëndetësisë në Kosovë, me fokus të veçantë në mbrojtjen financiare, shpenzimet jashtë xhepit, mekanizmat e grumbullimit të premiumeve, si dhe iniciativat ligjore në zhvillim. Në vend që të kufizohet në analizë për një vit të vetëm buxhetor, dokumenti shqyrton trendet e viteve të fundit si dhe zhvillimet aktuale të reformës.

Qëllimi i këtij dokumenti është të vlerësojë se si arkitektura e financimit të shëndetësisë në Kosovë ndikon në barazi, qëndrueshmëri fiskale dhe progres drejt mbulimit universal në shërbimet shëndetësore, si dhe të identifikojë rrugë të mundshme reforme që mund të përforcojnë mbrojtjen financiare dhe performancën e përgjithshme të sistemit.

Falënderime

Autorët dëshirojnë të falënderojnë ekspertët dhe akademikët në vijim për komentet dhe kontributet e tyre të vlefshme gjatë përgatitjes së këtij dokumenti:

Prof. Dr. Ilir Hoxha

Prof. Ass. Dr. Ariana Bytyçi-Katanolli

Agron Bytyqi dhe Besim Kodra, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK)

Citimi

Ky dokument është i destinuar për përdorim publik dhe mund të citohet, riprodhohet dhe shpërndahet për qëllime jo-komerciale, me kusht që të jepet referenca e duhur.

Citimi i sugjeruar:

Gashi, A., Ukmata, D., Agani, F., Tolaj, I. (2026). *Health Financing and Financial Protection in Kosovo*. ISEE–HSP Policy Brief.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
Seksioni 1: Konteksti i financimit të shëndetësisë dhe zhvillimet reformuese	3
Seksioni 2: Struktura dhe karakteristikat kryesore të sistemit të financimit të shëndetësisë.....	5
Seksioni 3: Parakushtet e sistemit për një reformë efektive të financimit të shëndetësisë	11
Seksioni 4: Mbrojtja financiare dhe pagesat jashtë xhepit (Out-of-Pocket – OOP)	14
Seksioni 5: Kujdesi shëndetësor ndërkufitar dhe implikimet për financim të shëndetësisë.....	19
Seksioni 6: Reforma e sigurimeve shëndetësore: Grumbullimi i premieeve, blerja dhe kapaciteti i sistemit	24
Seksioni 7: Skenarët e reformës dhe opsionet e politikave.....	29
Seksioni 8: Rreziqet e implementimit dhe kufizimet e sistemit	35
Seksioni 9: Përfundimet dhe implikimet strategjike	39
Seksioni 10: Veprimet politike dhe prioritetet e implementimit.....	41
Referencat	44

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë mbetet kryesisht i bazuar në buxhetin qeveritar dhe karakterizohet nga një varësi e lartë nga pagesat jashtë xhepit (out-of-pocket – OOP) të familjeve. Në mungesë të një skeme plotësisht funksionale të sigurimeve shëndetësore publike, rreziku financiar bartet drejtpërdrejt nga individët në momentin e përdorimit të shërbimeve.

Në kuadër të kornizave ndërkombëtare të financimit të shëndetësisë, mbrojtja financiare në shëndetësi përbën një dimension thelbësor të mbulimit universal në shërbimet shëndetësore, i cili kërkon që individët të kenë qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore pa u përballur me vështirësi financiare^(1,2). Të dhënat e disponueshme tregojnë se pagesat jashtë xhepit (OOP) në Kosovë përbëjnë rreth 38–40% të shpenzimeve totale në shëndetësi, duke tejkaluar ndjeshëm nivelet e vërejtura në shumicën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian^(1,3).

Varësia e lartë nga pagesat direkte të familjeve rrit gjasat për shpenzime katastrofike në shëndetësi, të cilat zakonisht përkufizohen si shpenzime që tejkalojnë 10% ose 25% të konsumit total të familjes⁽⁴⁾. Nivelet e larta të pagesave jashtë xhepit lidhen me kapacitet më të dobët shpërndarëse, ekspozim më të madh të familjeve me të ardhura të ulëta dhe qëndrueshmëri financiare më të ulët në nivel popullate^(5,6).

Kosova ka krijuar bazën ligjore për sigurimet shëndetësore të detyrueshme përmes Ligjit Nr. 04/L-249 (2014), i cili është amendamentuar në vitin 2022^(7,8). Në vitin 2024, Qeveria miratoi Draft Ligjin për Sigurimet Shëndetësore të Detyrueshme, me qëllim funksionalizimin e një fondi të konsoliduar grumbullimin e premieeve dhe formalizimin e mekanizmave të blerjes së shërbimeve⁽⁹⁾. Megjithatë, evidenca ndërkombëtare sugjeron se vetëm miratimi i legjisllacionit nuk garanton përmirësim të mbrojtjes financiare pa kapacitete adekuate administrative dhe qëndrueshmëri fiskale^(5,6).

Në mënyrë thelbësore, përvoja ndërkombëtare tregon se reforma e financimit të shëndetësisë nuk mund të zbatohet në mënyrë efektive pa transformim paralel të institucioneve ofruese të shërbimeve. Funksionimi paralel i mekanizmave në zhvillim të blerjes strategjike me një strukturë ofruesish kryesisht të bazuar në buxhet mund të kufizojë efektivitetin e reformës. Prandaj, evoluimi gradual i ofruesve kryesorë publikë drejt modeleve më autonome dhe të afta për kontraktim duhet të konsiderohet si pjesë integrale e reformës, dhe jo si një proces paralel apo opsional.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën (2024) thekson rëndësinë e përforcimit të qeverisjes fiskale dhe kapaciteteve institucionale në kuadër të procesit më të gjerë të integritetit

evropian⁽¹⁰⁾. Si rrjedhojë, reforma e financimit të shëndetësisë nuk është vetëm një çështje sektoriale, por pjesë e një agjende më të gjerë të qeverisjes dhe mbrojtjes sociale.

Ky dokument konkludon se arkitektura e financimit të shëndetësisë në Kosovë ndodhet në një pikë kthese strukturore. Pa forcimin e mekanizmave të grumbullimit të premiumeve dhe uljen e varësisë nga pagesat direkte të familjeve, rreziku financiar do të vazhdojë të mbetet në mënyrë disproporcionale në nivelin e familjeve.

Për këtë arsye, një qasje e kujdesshme dhe në faza e reformës është thelbësore. Në afat të shkurtër, prioritet duhet t'i jepet përforcimit të mbrojtjes financiare dhe kapaciteteve institucionale. Në afat të mesëm, duhet të zhvillohen mekanizma të strukturuar të grumbullimit të premiumeve. Ndërsa implementimi i plotë i sigurimeve shëndetësore të detyrueshme duhet të ndiqet vetëm atëherë kur ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme administrative, mekanizma të fortë të qeverisjes dhe qëndrueshmëri fiskale.

Seksioni 1: Konteksti i financimit të shëndetësisë dhe zhvillimet reformuese

Financimi i shëndetësisë është një përcaktues kyç i performancës së sistemit shëndetësor, duke ndikuar si në disponueshmërinë e burimeve, ashtu edhe në shpërndarjen e rrezikut financiar. Sipas kornizave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Mbulimi i Përgjithshëm Shëndetësor (MPSH) kërkon që individët të kenë qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore pa u përballur me vështirësi apo barriera financiare^(1,2).

Mbrojtja financiare arrihet kryesisht përmes mekanizmave të parapagimit dhe grumbullimit të premieeve, të cilët shpërndajnë kontributet financiare në nivel të popullatës përpara se të ndodhë sëmundja. Sistemet e bazuara në taksa dhe modelet e sigurimeve shëndetësore të detyrueshme janë të dizajnuara për të shpërndarë rrezikun dhe për të reduktuar pagesat direkte në momentin e përdorimit të shërbimeve^(5,6). Në të kundërt, sistemet me varësi të lartë nga pagesat jashtë

Sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë karakterizohet nga një varësi e lartë nga pagesat jashtë xhepi, mekanizma të kufizuar të grumbullimit të premieeve dhe nivele mesatare të shpenzimeve publike.

xhepit (out-of-pocket – OOP) e zhvendosin rrezikun financiar te individët dhe familjet, duke rritur gjasat për shpenzime katastrofike dhe qasje të pabarabartë në kujdes shëndetësor^(4,5).

Sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë karakterizohet nga tri veçori të ndërlidhura:

- varësi e lartë nga pagesat jashtë xhepit;
- mekanizma të kufizuar të grumbullimit të premieeve;
- nivel mesatar i shpenzimeve publike.

Sistemi mbetet kryesisht i financuar përmes taksave, ku të hyrat publike përbëjnë burimin kryesor të financimit. Megjithatë, në mungesë të një mekanizmi plotësisht funksional të grumbullimit të premieeve të bazuar në sigurime, pagesat e familjeve vazhdojnë të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale në shëndetësi^(1,3).

Kjo strukturë e financimit duhet të kuptohet brenda një konteksti më të gjerë institucional dhe fiskal. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën (2024) thekson nevojën për përf forcimin e administratës publike, qëndrueshmërisë fiskale dhe kapaciteteve të qeverisjes në të gjitha sektorët⁽¹⁰⁾. Prandaj, reforma e financimit të shëndetësisë është ngushtë e lidhur me kapacitetin më të gjerë shtetëror dhe performancën e sektorit publik.

Baza ligjore për sigurimet shëndetësore të detyrueshme ekziston që nga viti 2014⁽⁷⁾, me amendamente të miratuara në vitin 2022⁽⁸⁾. Së fundmi, Draft Ligji për Sigurimet Shëndetësore të Detyrueshme (2024) përfaqëson një përpjekje të re për të operacionalizuar mekanizmat e grumbullimit të premiumeve, për të përcaktuar përfitimet dhe për të vendosur mekanizma të strukturuar të blerjes së shërbimeve⁽⁹⁾. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare tregon se efektiviteti i këtyre reformave nuk varet vetëm nga korniza ligjore, por edhe nga gatishmëria administrative, kapaciteti për mbledhjen e kontributeve dhe sistemet transparente të qeverisjes^(5,6).

Përtej rolit të tij në mbrojtjen financiare dhe ofrimin e shërbimeve, sektori i shëndetësisë mund të shihet edhe në një perspektivë më të gjerë ekonomike dhe zhvillimore. Në shumë vende, sistemet shëndetësore kontribuojnë në rritjen ekonomike përmes punësimit, inovacionit dhe ofrimit të shërbimeve ndërkufitare. Në këtë kontekst, zhvillimi i shërbimeve të specializuara dhe potenciali për turizëm shëndetësor, duke synuar popullatat në rajon dhe diasporë, mund të përfaqësojnë një rrugë plotësuese për përforsimin e qëndrueshmërisë financiare dhe kapaciteteve të sistemit në Kosovë.

Në përgjithësi, sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë mund të karakterizohet si në një fazë tranzicioni ndërmjet një modeli tradicional të bazuar në buxhet dhe një sistemi më të strukturuar, të bazuar në grumbullimin e premiumeve. Kjo fazë tranzitore krijon si mundësi, ashtu edhe rreziqe. Pa një reformë në faza dhe të mirëplanifikuar, joefikasitetet strukturore dhe ekspozimi financiar i familjeve ka gjasa të vazhdojnë, pavarësisht përpjekjeve ligjore në zhvillim.

Seksioni 2: Struktura dhe karakteristikat kryesore të sistemit të financimit të shëndetësisë

2.1 Arkitektura institucionale

Sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë është i organizuar kryesisht si një model i financiar përmes taksave, ku burimet publike alokohen përmes buxhetit të shtetit. Përgjegjësitë për financim ndahen ndërmjet nivelit qendror dhe atij komunal, duke rezultuar në një strukturë të decentralizuar, por njëkohësisht edhe të fragmentuar të sistemit.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për financimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar, ndërsa komunat menaxhojnë dhe financojnë kujdesin primar shëndetësor. Megjithëse kjo ndarje e përgjegjësisë mundëson ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve, ajo gjithashtu krijon sfida në koordinim dhe potencial për joefikasitet në alokimin e burimeve ndërmjet niveleve të ndryshme të kujdesit shëndetësor.

Sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë reflekton tri sfida kryesore strukturore:

- fragmentim të financimit ndërmjet niveleve të kujdesit shëndetësor
- kapacitete të kufizuara për blerje strategjike
- mospërputhje ndërmjet reformave të financimit dhe organizimit të ofruesve të shërbimeve

Mekanizmat e alokimit buxhetor mbeten kryesisht të bazuar në inpute, ku financimi lidhet me shpenzimet historike, dhe jo me nevojat e popullatës, rezultatet e shërbimeve apo indikatorët e performancës. Kjo kufizon stimujt për efikasitet, përmirësim të cilësisë dhe ofrim të shërbimeve të orientuara në bazë të rezultateve.

Një çështje qendrore është mungesa e ndarjes së qartë ndërmjet rolit të blerësit dhe ofruesit të shërbimeve. Ndërsa reformat synojnë krijimin e një Fondi të Sigurimeve Shëndetësore si blerës strategjik, ofruesi kryesor publik si Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), vazhdon të funksionojë si një institucion tradicional i bazuar në buxhet.

Kjo krijon një mospërputhje strukturore brenda sistemit: nga njëra anë, reformat po lëvizin drejt një modeli të bazuar në grumbullimin e premieeve dhe blerjen strategjike; nga ana tjetër, ofruesi kryesor mbetet i integruar në një kornizë administrative të bazuar në buxhet. Kjo mospërputhje kufizon zhvillimin e marrëdhënieve kontraktuale, redukton llogaridhënien e ofruesve dhe dobëson efektivitetin e mekanizmave të financimit të bazuar në performancë.

Përvoja ndërkombëtare sugjeron se reforma efektive e financimit të shëndetësisë kërkon harmonizim ndërmjet mënyrës së financimit, organizimit të ofruesve dhe strukturave të qeverisjes^(5,6). Në veçanti, blerja strategjike varet nga ekzistenca e ofruesve autonomë që janë të aftë të kontraktjnë, të menaxhojnë burimet në mënyrë fleksibile dhe të mbahen përgjegjës për performancën dhe rezultatet.

Në këtë kontekst, një drejtim i mundshëm strategjik për Kosovën mund të përfshijë transformimin gradual të Shërbimit Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) në një institucion më autonom, të organizuar klinikisht dhe të aftë për kontraktim. Përvojat nga sistemet shëndetësore evropiane tregojnë se rritja e autonomisë së ofruesve, e kombinuar me mekanizma të qartë të llogaridhënies, mund të përmirësojë efikasitetin dhe reagimin ndaj nevojave të pacientëve.

Reforma e shëndetit mendor në Kosovë ofron një shembull të rëndësishëm vendor. Shërbimet e bazuara në komunitet, të organizuara përmes Qendrave të Shëndetit Mendor dhe strukturave të mbështetura të banimit, janë financuar përmes linjave të dedikuara buxhetore dhe janë strukturuar sipas njësive funksionale të shërbimit. Ky model demonstroi se si organizimi sipas linjave të shërbimit mund të përmirësojë integrimin e kujdesit dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve, duke ofruar mësim të vlefshme për reformën më të gjerë të sistemit.

2.2 Shpenzimet në shëndetësi dhe modelet e financimit

Vlerësimi i qëndrueshmërisë financiare kërkon analizimin e shpenzimeve shëndetësore në raport me Bruto Produkti Vendor (BPV) dhe shpenzimet totale qeveritare.

Evidenca e disponueshme tregon se shpenzimet për shëndetësinë në Kosovë mbeten relativisht të ulëta krahasuar me standardet e Bashkimit Evropian^(1,3).

Shpenzimet totale në shëndetësi vlerësohen në rreth 4.0 – 4.5% të BPV-së, ndërsa shpenzimet publike për shëndetësinë përbëjnë rreth 3.0 – 3.5% të BPV-së.

Këto nivele janë dukshëm më të ulëta se mesatarja e vendeve të BE-së, ku shpenzimet totale për shëndetësi zakonisht tejkalojnë 9 – 11% të BPV-së⁽³⁾.

Shpenzimet publike për shëndetësinë në Kosovë mbeten relativisht të ulëta, të vlerësuara në rreth 3 – 3.5% të Bruto Produkti Vendor (BPV), dukshëm më të ulëta se në shumicën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe më të ulëta se mesatarja rajonale.

Në të njëjtën kohë, pagesat jashtë xhepit (out-of-pocket – OOP) përbëjnë rreth **38–40% të shpenzimeve totale në shëndetësi**⁽¹⁾. Kjo është dukshëm më e lartë se nivelet në Bashkësinë Evropiane (**zakonisht 15–20%**) dhe lidhet me mbrojtje më të dobët financiare dhe rrezik më të lartë për shpenzime katastrofike^(2,4).

Në përgjithësi, struktura e financimit në Kosovë reflekton:

- nivel relativisht të ulët të financimit publik në krahasim me vendet e BE-së;
- varësi të lartë nga pagesat e familjeve;
- rishpërndarje të kufizuar përmes mekanizmave të grumbullimit të premieeve

Tabela 1: Trendet e shpenzimeve shëndetësore në Kosovë (2019–2024)

Viti	Shpenzimet qeveritare (milion Euro)	Shpenzimet publike për shëndetësinë (% e BPV)	Shpenzimet totale në shëndetësi – CHE (% e BPV)	Pagesat jashtë xhepit OOP (% CHE)
2019	215.7	3.06%	~ 4.5	~ 37
2020	250.5	3.70%	~ 3.7	~ 38
2021	273.2	3.43%	~ 3.7	~ 38
2022	236.1	2.64%	~ 4.2	~ 39
2023	302.7	3.08%	~ 4.2–4.4 (vlers.)	~ 38–39 (vlers.)
2024	348.2	~3.3%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

Shënim: CHE i referohet shpenzimeve totale kombëtare për shëndetësi, ndërsa BPV i referohet Bruto Produkti Vendor.

Të dhënat për shpenzimet qeveritare për vitet 2019–2024 bazohen në raportet e Buxhetit të Kosovës, Zyrrës Kombëtare të Auditimit dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Vlerësimet për CHE dhe OOP janë nxjerrë nga databaza ndërkombëtare dhe analiza kombëtare. Për shkak të raportimit të paplotë në databazat ndërkombëtare, vlerat për vitin 2023 janë indikative dhe bazohen në analizë trendi. Të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura për qëllime interpretimi në politikëbërje.

Projeksionet paraprake për buxhetin e vitit 2025 sugjerojnë një rritje të moderuar të shpenzimeve publike për shëndetësinë, megjithatë të dhënat përfundimtare dhe të krahasueshme ende nuk janë në dispozicion.

Burimi: Buxheti i Kosovës (2019–2024), Zyra Kombëtare e Auditimit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, WHO Global Health Expenditure Database, Banka Botërore.

Tabela 2: Krahasimi i shpenzimeve shëndetësore – 2022 (Kosova, rajoni dhe BE)

Shteti	Shpenzimet totale për shëndetësi – CHE (% BPV)
Kosova	~ 4.0 – 4.5
Shqipëria	~ 5.3
Maqedonia e Veriut	~ 7.8
Serbia	~ 9.1
Mali i Zi	~ 9.3
Mesatarja e BE-së	~ 10.9

Burimi: OBSH; Banka Botërore; Eurostat.

Tabela 3: Indikatorët kryesorë të financimit të shëndetësisë

Indikatori	Kosova	Intervali tipik në BE	Interpretimi
<i>Shpenzimet totale për shëndetësi (% BPV)</i>	~ 4.0–4.5%	~ 9–11%	<i>Nivel i ulët i shpenzimeve</i>
<i>Shpenzimet publike për shëndetësi (% BPV)</i>	~ 3.0–3.5%	~ 6–8%	<i>Financim publik i kufizuar</i>
<i>Pagesat jashtë xhepit OOP (% CHE)</i>	~ 38–40%	~ 15–20%	<i>Barrë e lartë për familjet</i>
<i>Shpenzimet për kokë banori</i>	<i>Të ulëta</i>	<i>Të larta</i>	<i>Hendek fiskal</i>
<i>Grumbullimi i premieeve</i>	<i>I kufizuar</i>	<i>Universale</i>	<i>Rishpërndarje e dobët</i>

Burimi: Përpunim i autorëve bazuar në WHO Global Health Expenditure Database; Banka Botërore.

2.3 Sigurimet private shëndetësore dhe mbulimi vullnetar

Përveç skemave të financimit publik, sigurimet private shëndetësore (SPSh) përfaqësojnë një mekanizëm plotësues financimi brenda sistemit shëndetësor të Kosovës. Edhe pse shtrirja e tyre mbetet e kufizuar krahasuar me shumë vende të Bashkimit Evropian, produktet vullnetare

të sigurimit janë të pranishme dhe meritojnë vlerësim analitik si pjesë e arkitekturës së përgjithshme të financimit.

Në sistemet shëndetësore evropiane, sigurimet private shëndetësore zakonisht kryejnë një nga tre funksione: mbulimin komplementar (që mbulon bashkëpagesat e përcaktuara me ligj); mbulim suplementar (që ofron shërbime ose komoditete shtesë); dhe mbulim të duplikuar (që ofron qasje paralele të ofruesit privatë jashtë sistemit publik)^(5,6).

Në Kosovë, tregu i sigurimeve private duket të jetë i përqendruar kryesisht në polisa grupore korporative dhe produkte individuale vullnetare të orientuara drejt popullatës së punësuar në sektorin formal. Mbulimi mbetet i kufizuar në raport me popullatën totale dhe SPSH aktualisht nuk përbën një shtyllë kryesore të financimit të sistemit shëndetësor. Megjithatë, ai ndërvepron me dinamikat më të gjera të financimit në disa mënyra të rëndësishme.

Nga perspektiva e financimit të shëndetësisë, disa konsiderata strukturore janë veçanërisht të rëndësishme:

1. Fragmentimi i grumbullimit të premieeve

Fondet e sigurimeve private vullnetare janë zakonisht më të vogla dhe selektive ndaj rrezikut. Ato mund të mbulojnë në mënyrë disproporcionale individë më të shëndetshëm ose me të ardhura më të larta, duke rritur potencialisht segmentimin brenda sistemit⁽⁵⁾.

2. Implikimet për barazinë

Kur sigurimet vullnetare u shërbejnë kryesisht grupeve me të ardhura më të larta ose të punësuarve në sektorin formal, qasja në shërbime më të shpejta ose me cilësi më të lartë mund të bëhet e varur nga të ardhurat. Në sisteme me nivele të larta të pagesave jashtë xhepit, SPSH mund të reduktojë barrën financiare për individët e siguruar, duke lënë të tjerët të ekspozuar^(2,6).

3. Ndikimi në incentivat e sektorit publik

Rritja e sigurimeve private duplikative mund të stimulojë zgjerimin e tregut të ofruesve privatë dhe të ndikojë në shpërndarjen e fuqisë punëtore. Pa koordinim të fortë rregullator, kjo ka potencial të rrisë praktikën e dyfishtë dhe të forcojë rrugët paralele të ofrimit të shërbimeve.

4. Ndërveprimi me reformën e sigurimeve të detyrueshme

Korniza e propozuar për sigurimet e detyrueshme⁽⁹⁾ duhet të qartësojë rolin e sigurimeve private vullnetare për të shmangur mbivendosjen, përzgjedhjen e pafavorshme dhe duplikimin e përfitimeve. Përvoja ndërkombëtare sugjeron se ndarja e qartë ndërmjet paketave publike të përfitimeve dhe mbulimit suplementar vullnetar përmirëson koherencën e sistemit⁽⁵⁾.

Me rëndësi është se sigurimet private vullnetare nuk e zëvendësojnë mbledhjen kombëtare të sigurimeve në arritjen e mbrojtjes së përgjithshme financiare. Edhe pse ato mund të diversifikojnë burimet e financimit dhe të ofrojnë mbrojtje shtesë për grupe të caktuara, ato nuk zgjerojnë në mënyrë të natyrshme rishpërndarjen në nivel të gjithë popullatës.

Nga perspektiva analitike, SPSH në Kosovë duhet të interpretohet si:

- një element plotësues i financimit;
- një faktor potencial që ndikon në barazi;
- një variabël strukturore që ndërvepron me reformën e grumbullimit publik të premiumeve.

Mbikëqyrja e kujdesshme rregullatore, transparenca në përkufizimin e përfitimeve dhe harmonizimi me objektivat më të gjera të financimit të shëndetësisë janë thelbësore për të siguruar që sigurimet vullnetare të mbështesin, dhe jo të fragmentojnë, sistemin shëndetësor.

Seksioni 3: Parakushtet e sistemit për një reformë efektive të financimit të shëndetësisë

Reforma e financimit të shëndetësisë nuk funksionon në izolim. Brenda kornizave të konsoliduara të sistemeve shëndetësore, mbrojtja financiare në shëndetësi dhe mekanizmat e grumbullimit të premiumeve varen nga performanca e komponentëve më të gjerë të sistemit, përfshirë ofrimin e shërbimeve, kapacitetin e fuqisë punëtore, qasjen në barna, qeverisjen dhe sistemet e informacionit shëndetësor^(13,14).

Përforcimi i këtyre elementeve themelore është thelbësor për të siguruar që reformat e financimit të përkthehen në përmirësim të barazisë, efikasitetit dhe performancës së sistemit. Pa një nivel të mjaftueshëm të gatishmërisë së sistemit, reformat që synojnë zgjerimin e mekanizmave të grumbullimit të premiumeve apo futjen e skemave të sigurimit rrezikojnë të mbeten formale, me ndikim të kufizuar praktik^(13,14).

Prandaj, reforma e financimit të shëndetësisë në Kosovë duhet të kuptohet si pjesë e një transformimi më të gjerë të sistemit, dhe jo si një ndërhyrje e izoluar politike.

3.1 Ofrimi i shërbimeve dhe vazhdimësia e kujdesit

Reforma e financimit të shëndetësisë në Kosovë kufizohet jo vetëm nga niveli i financimit, por edhe nga gatishmëria e sistemit, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve, qeverisjes dhe sistemet e informimit.

Kosova ka vendosur struktura të kujdesit primar, sekondar dhe terciar. Megjithatë, mbeten boshllëqe të rëndësishme në vazhdimësinë, integrimin dhe koordinimin e kujdesit. Shërbimet si rehabilitimi dhe kujdesi paliativ nuk janë të integruara në mënyrë konsistente në sistemin e financuar publikisht. Gjithashtu, kujdesi shëndetësor primar ende nuk funksionon plotësisht sipas modelit të mjekësisë familjare me lista të përcaktuara të pacientëve dhe

mekanizmit efektiv të kontaktit të parë të sistemit shëndetësor.

Këto kufizime reduktojnë efikasitetin e sistemit, dobësojnë koordinimin e kujdesit dhe e bëjnë më të vështirë hartimin e paketave koherente të përfitimeve dhe mekanizmave të blerjes. Përvoja ndërkombëtare tregon se sistemet e forta të kujdesit primar, veçanërisht ato me funksion të kontaktit të parë në sistemin shëndetësor (gatekeeper), janë kritike për përdorim efikas të burimeve dhe kontroll të kostove⁽¹⁶⁾.

Pa një model funksional të ofrimit të shërbimeve, zgjerimi i mekanizmave të financimit mund të çojë në rritje të përdorimit të shërbimeve pa përmirësim përkatës të rezultateve shëndetësore.

3.2 Alokimi i të hyrave dhe planifikimi

Alokimi i financave në shëndetësi në Kosovë mbetet kryesisht i drejtuar nga proceset buxhetore, dhe jo nga një vlerësim sistematik i nevojave.

Kjo mund të çojë në variabilitet në shpërndarjen e burimeve financiare dhe të kufizojë parashikueshmërinë e flukseve financiare ndërmjet institucioneve dhe niveleve të kujdesit. Alokimet buxhetore nuk janë gjithmonë të harmonizuara me nevojat shëndetësore të popullatës, kërkesën për shërbime apo indikatorët e performancës.

Evidenca ndërkombëtare sugjeron se sistemet e qëndrueshme të premieeve dhe sigurimeve kërkojnë mekanizma transparentë dhe të bazuar në rregulla për alokimin e burimeve, të harmonizuar me profilet epidemiologjike dhe demografike^(13,14).

Pa mekanizma të tillë, reformat e financimit mund të mos arrijnë përmirësimet e synuara në barazi dhe efikasitet.

3.3 Kapacitetet e fuqisë punëtore shëndetësore

Ndërsa kapacitetet e fuqisë punëtore janë relativisht të qëndrueshme në nivelet primare dhe sekondare, boshllëqet mbeten në shërbimet e specializuara në nivel terciar.

Disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve të subspecializuara kontribuon në vazhdimin e varësisë nga trajtimi jashtë vendit dhe kufizon aftësinë e sistemit për t'iu përgjigjur nevojave komplekse shëndetësore.

Shpërndarja, specializimi dhe mbajtja e fuqisë punëtore janë faktorë kyç për përfundimin e ofrimit të shërbimeve brenda vendit dhe reduktimin e varësisë për shërbime nga jashtë.

Pa kapacitete të mjaftueshme njerëzore profesionale në shëndetësi, zgjerimi i financimit nuk ka gjasa të përmirësojë ndjeshëm qasjen apo performancën e sistemit shëndetësor.

3.4 Barnat dhe produktet mjekësore

Mungesa e një sistemi plotësisht të standardizuar dhe të bazuar në nevoja për prokurimin dhe rimbursimin e barnave redukton parashikueshmërinë dhe mund të kontribuojë në joefikasitet në shpenzimet farmaceutike. Pagesat jashtë xhepit për barna mbeten një komponent i rëndësishëm i shpenzimeve të familjeve, duke reflektuar boshllëqe në mbulimin publik.

Vendosja e një liste transparente dhe të bazuar në evidencë të barnave, e harmonizuar me protokollat klinike dhe mekanizmat e rimbursimit, është thelbësore për forcimin e mbrojtjes financiare dhe për një alokim më efikas të burimeve⁽¹⁷⁾.

3.5 Qeverisja dhe sistemet e informimit shëndetësor

Një sistem funksional i informimit shëndetësor (SISh) është një kërkesë themelore për sistemet moderne të financimit të shëndetësisë. Ai mundëson regjistrimin e popullatës, ndjekjen e shërbimeve, menaxhimin e kërkesave për rimbursim dhe llogaridhënien financiare.

Pavarësisht investimeve afatgjata, sistemi SISh në Kosovë mbetet vetëm pjesërisht funksional. Kufizimet në disponueshmërinë e të dhënave, ndërveprueshmërinë dhe raportimin në kohë reale kufizojnë mbikëqyrjen e sistemit dhe reduktojnë efektivitetin e funksioneve të planifikimit dhe blerjes.

Përvoja ndërkombëtare tregon se grumbullimi efektiv i premieeve dhe blerja strategjike varen nga sisteme të besueshme të të dhënave, mekanizma transparentë raportimi dhe struktura të forta qeverisjeje^(14,15).

Pa këto elemente, implementimi i mekanizmave të financimit të bazuar në sigurime mund të përballë me rreziqe të konsiderueshme operacionale, përfshirë joefikasitetin, vonesat në rimbursim dhe uljen e llogaridhënies.

Analiza nxjerr në pah një kufizim qendror: reforma e financimit të shëndetësisë në Kosovë kufizohet jo vetëm nga niveli i financimit, por edhe nga gjendja dhe gatishmëria e sistemit.

Boshllëqet në ofrimin e shërbimeve, qeverisje dhe sistemet e informimit reduktojnë kapacitetin e sistemit për t'i përkthyer reformat financiare në rezultate konkrete.

Prandaj, një qasje në faza e reformës është thelbësore. Përforcimi i funksioneve bazë të sistemit, veçanërisht kujdesit primar, sistemeve të të dhënave dhe qeverisjes, duhet të paraprijë ose të ecë paralelisht me zgjerimin e mekanizmave të grumbullimit të premieeve dhe sigurimeve.

Seksioni 4: Mbrojtja financiare dhe pagesat jashtë xhepit (Out-of-Pocket – OOP)

4.1 Mbrojtja financiare në shëndetësi dhe pagesat jashtë xhepit

Pagesat jashtë xhepit (out-of-pocket – OOP) janë një indikator kyç i mbrojtjes financiare në një sistem shëndetësor. Në kuadër të Mbulimit Universal në Shërbimet Shëndetësore, individët duhet të kenë qasje në shërbimet e nevojshme pa u përballur me vështirësi financiare^(1,2).

Në Kosovë, pagesat jashtë xhepit (OOP) përbëjnë rreth 38–40% të shpenzimeve totale në shëndetësi, dukshëm më të larta se në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, ku këto nivele zakonisht variojnë ndërmjet 15–20%^(1–3).

Varësia e lartë nga pagesat direkte reflekton mekanizma të kufizuar të parapagimit dhe grumbullimit të premiumeve, si dhe tregon ekspozim të shtuar të familjeve ndaj rrezikut financiar^(1,2).

Standardet ndërkombëtare sugjerojnë se kur pagesat direkte apo jashtë xhepit (OOP) tejkalojnë rreth 20% të shpenzimeve totale në shëndetësi, rreziku për shpenzime katastrofike në shëndetësi dhe varfëruese rritet ndjeshëm^(2,4).

Në Kosovë, pagesat jashtë xhepi burojnë nga disa kategori shërbimesh, përfshirë barnat, shërbimet diagnostike, konsultat specialistike dhe, në disa raste, pagesat joformale^(1,11). Faktorë strukturorë si disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve në sektorin publik, kohët e gjata të pritjes dhe perceptimet për dallime në cilësi mund të shtyjnë pacientët drejt ofruesve privatë, ku shërbimet zakonisht paguhen drejtpërdrejt nga xhepi^(11,12).

Kombinimi i shpenzimeve publike relativisht të ulëta dhe varësisë së lartë nga pagesat jashtë xhepi (OOP) rrit gjasat për vështirësi financiare, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta, të cilat kanë më pak mundësi për të përballuar kostot e papritura shëndetësore dhe përballen më shpesh me barriera në qasje në kujdes.

Pagesat jashtë xhepit (out-of-pocket – OOP) në Kosovë (~38–40%) janë pothuajse dyfish më të larta se mesatarja e BE-së (~15–20%). Kjo tregon mbrojtje të kufizuar financiare dhe rrezik të lartë për shpenzime katastrofike në shëndetësi.

Figura 1. Pagesat jashtë xhepit (Out-of-Pocket) si përqindje e shpenzimeve totale në shëndetësi: Kosova krahasuar me mesataren e BE-së



Burimi: WHO Global Health Expenditure Database; OECD Health at a Glance.

Nga perspektiva e sistemit, varësia e lartë nga pagesat jashtë xhepit (OOP) dobëson funksionin rishpërndarës të financimit të shëndetësisë. Në vend që premiumet të shpërndahet në nivel të popullatës, barra financiare bartet drejtpërdrejt nga individët në momentin e përdorimit të shërbimeve, duke reduktuar barazinë dhe duke cenuar parimet themelore të Mbulimit Universal në Shërbimet Shëndetësore^(5,6).

Përvoja ndërkombëtare tregon se ulja e pagesave direkte - jashtë xhepit (OOP) kërkon përforsimin e mekanizmave të parapagimit dhe grumbullimit të premiumeve, zgjerimin e mbulimit të shërbimeve thelbësore dhe përmirësimin e mekanizmave të blerjes së shërbimeve. Sistemet që mbështeten në blerje strategjike dhe paketa të qarta të përfitimeve janë më të pozicionuara për të kontrolluar kostot dhe për të mbrojtur familjet nga rreziku financiar^(5,6).

4.2 Shpenzimet katastrofike në shëndetësi

Shpenzimet katastrofike në shëndetësi zakonisht përkufizohen si shpenzime që tejkalojnë një prag të caktuar të të ardhurave ose konsumit total të familjes, shpesh në nivelin 10% ose 25%⁽⁴⁾.

Evidenca ndërkombëtare tregon një lidhje të fortë ndërmjet niveleve të larta të pagesave direkt nga xhepi (OOP) dhe rritjes së shpenzimeve katastrofike^(2,4). Sistemet me grumbullim të kufizuar të premiumeve dhe pagesa të larta në momentin e përdorimit të shërbimeve kanë tendencë të krijojnë vulnerabilitet financiar më të lartë, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta.

Nivelet e larta të pagesave jashtë xhepit në Kosovë nuk përbëjnë vetëm një çështje financimi. Ato reflektojnë boshllëqe më të thella strukturore, përfshirë grumbullim të premiumeve, mekanizma të kufizuar të blerjes dhe mospërputhje ndërmjet reformave të financimit dhe organizimit të ofruesve të shërbimeve.

Megjithëse të dhënat gjithëpërfshirëse për Kosovën janë të kufizuara, evidenca ekzistuese sugjeron se rreziku financiar shpërndahet në mënyrë të pabarabartë ndërmjet grupeve të popullsisë. Familjet që menaxhojnë sëmundje kronike, terapi afatgjata apo kosto të përsëritura ambulatorie janë veçanërisht më të prekura.

Është e rëndësishme të theksohet se shpenzimet katastrofike nuk lindin vetëm nga ndërhyrje të mëdha spitalore. Ato mund të rezultojnë nga efekti kumulativ i shpenzimeve rutinë, përfshirë barnat, diagnostikën dhe konsultat e përsëritura.

Përveç kostove direkte mjekësore, familjet përballen edhe me shpenzime indirekte si transporti, akomodimi dhe humbja e të ardhurave. Këto shpesh nuk përfshihen në statistikat zyrtare, por mund të rrisin ndjeshëm barrën financiare të sëmundjes.

Nga perspektiva strukturore, varësia e lartë nga pagesat jashtë xhepit (OOP) reflekton mungesë të plotë të grumbullimit të premieeve. Në mungesë të mekanizmave të konsoliduar të financimit, familjet veprojnë si paguesit kryesorë të mbetur në sistem, duke kufizuar rishpërndarjen dhe mbrojtjen për grupet vulnerabël^(5,6).

4.3 Implikimet për barazinë në financimin e shëndetësisë

Mbrojtja financiare është ngushtë e lidhur me barazinë në qasjen në shërbime shëndetësore. Kur një pjesë e madhe e financimit mbështetet në pagesa direkte, familjet me të ardhura më të ulëta përballen me barriera më të mëdha për të marrë kujdesin e nevojshëm.

Në Kosovë, niveli relativisht i lartë i pagesave jashtë xhepit (OOP) sugjeron se barra financiare e kujdesit shëndetësor bie në mënyrë disproporcionale mbi familjet me burime më të kufizuara. Evidenca ndërkombëtare tregon se varësia e lartë nga pagesat direkte kontribuon në pabarazi në përdorimin e shërbimeve, pasi disa familje mund të vonojnë ose shmangin kërkimin e kujdesit për shkak të kufizimeve financiare^(2,5).

Dallimet në kapacitetin financiar ndikojnë gjithashtu në qasjen në shërbime private apo trajtim jashtë vendit. Individët me të ardhura më të mira financiare mund të anashkalojnë kufizimet e sistemit publik, ndërsa të tjerët mbeten të varur nga shërbimet publike.

Grupet më të prekura përfshijnë pacientët me sëmundje kronike, individët që kërkojnë terapi afatgjata si trajtimi onkologjik, personat me aftësi të kufizuara dhe popullatat në zonat rurale apo në vendet ku nuk mjaftueshëm shërbime shëndetësore.

Pa mekanizma efektive të mbrojtjes financiare, këto dinamika rrezikojnë të thellojnë pabarazitë ekzistuese dhe të zgjerojnë dallimet në rezultatet shëndetësore.

4.4 Implikimet në nivel të sistemit shëndetësor

Varësia e lartë nga pagesat jashtë xhepit ka implikime më të gjera përtej barrës individuale financiare.

Së pari, ajo kufizon kapacitetin për blerje strategjike. Kur një pjesë e madhe e shpenzimeve ndodh jashtë mekanizmave të grumbullimit të premieeve, blerësit publikë kanë më pak mundësi për të ndikuar sjelljen e ofruesve dhe për të kontrolluar kostot⁽⁵⁾.

Së dyti, ajo kufizon planifikimin. Shpenzimet e larta të familjeve mund të maskojnë nevojat e paplotësuara dhe të deformojnë sinjalet e kërkesës brenda sistemit shëndetësor.

Së treti, ajo mund të dëmtojë besimin publik. Kur qasja në kujdes shëndetësor varet nga pagesa direkte, besimi në institucionet publike bie. Prandaj, mbrojtja financiare në shëndetësi është gjithashtu një çështje e qeverisjes dhe e kontratës sociale.

Nga perspektiva e sistemit, nivelet e larta të pagesave jashtë xhepit (OOP) tregojnë për grumbullim të paplotë të premieeve dhe rishpërndarje të kufizuar. Përforcimi i mbrojtjes financiare kërkon si rritje të burimeve të përbashkëta, ashtu edhe përmirësim të mekanizmave të blerjes^(5,6).

4.5 Interpretimi strukturor

Analiza nxjerr në pah një çështje qendrore strukturore: sistemi i financimit të shëndetësisë në Kosovë vendos një pjesë të konsiderueshme të rrezikut financiar mbi familjet.

Kjo reflekton si nivelet relativisht modeste të financimit publik, ashtu edhe mungesën e konsolidimit të plotë të mekanizmave të grumbullimit të premieeve. Edhe pse korniza ligjore për sigurimet shëndetësore të detyrueshme ofron një bazë për reformë⁽⁷⁻⁹⁾, zbatimi efektiv kërkon harmonizim me kapacitetin fiskal, gatishmërinë administrative dhe mekanizma të fortë monitorues të qeverisjes⁽¹⁰⁾.

Analiza e mësipërme thekson disa karakteristika strukturore të sistemit të financimit të shëndetësisë në Kosovë, të cilat kanë implikime të drejtpërdrejta për mbrojtjen financiare dhe qëndrueshmërinë.

Shpenzimet totale për shëndetësi mbeten relativisht modeste në krahasim me standardet evropiane, duke kufizuar kapacitetin për zgjerimin e mbulimit dhe forcimin e mbrojtjes financiare. Në të njëjtën kohë, një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve shëndetësore financohet drejtpërdrejt nga familjet, duke i ekspozuar ato ndaj rrezikut financiar dhe duke kontribuar në pabarazi në qasje.

Mungesa e një mekanizmi të konsoliduar të grumbullimit të premieeve kufizon më tej rishpërndarjen. Pavarësisht ekzistencës së një kornize ligjore, zbatimi ende nuk ka rezultuar në një sistem plotësisht funksional të grumbullimit dhe blerjes të shërbimeve.

Paralelisht, zhvillimi i sektorit privat dhe modelet e shpenzimeve të familjeve vazhdojnë të ndikojnë në përdorimin e shërbimeve, ku shumë familje mbështeten në pagesa private, përfshirë edhe për trajtim jashtë vendit.

Në tërësi, këto dinamika tregojnë se përmirësimi i mbrojtjes financiare kërkon një kombinim të rritjes së investimeve publike, përforcimit të mekanizmave të grumbullimit të premieeve dhe harmonizimit më të mirë ndërmjet mënyrave të financimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Seksioni 5: Kujdesi shëndetësor ndërkufitar dhe implikimet për financim të shëndetësisë

5.1 Trajtimi jashtë Kosovës

Kujdesi shëndetësor ndërkufitar përfaqëson një komponent të dukshëm dhe politikisht të ndjeshëm të sistemit shëndetësor në Kosovë. Edhe pse nuk është i pazakontë në sisteme të vogla shëndetësore, implikimet e tij duhet të vlerësohen në raport me qëndrueshmërinë fiskale, barazinë dhe zhvillimin afatgjatë të sistemit.

Në Kosovë, trajtimi jashtë vendit reflekton kryesisht kapacitetet të kufizuara vendor në shërbime shumë të specializuara, veçanërisht në diagnostikë të avancuar dhe procedura mjekësore komplekse.

Në vend që të interpretohet si dështim i sistemit, kujdesi ndërkufitar mund të kuptohet si një sinjal strukturor, që pasqyron ndërveprimin ndërmjet kufizimeve të kapacitetit të shërbimeve, mekanizmave të financimit dhe dizajnit institucional.

Në sisteme si ai i Kosovës, kujdesi shëndetësor ndërkufitar shpesh reflekton kapacitete të kufizuara vendore në shërbime shumë të specializuara, veçanërisht në diagnostikë të avancuar dhe procedura kirurgjikale komplekse.

5.2 Trajtimi jashtë vendit i financuar publikisht

Kosova alokon mjete financiare publike për financimin e trajtimit jashtë vendit kur shërbime të caktuara nuk janë të disponueshme brenda vendit. Këto raste zakonisht rregullohen përmes procedurave administrative dhe kritereve të caktuara.

Nga perspektiva e financimit, trajtimi jashtë vendit i financuar publikisht përfaqëson një formë të blerjes së jashtme të shërbimeve, ku shteti blen shërbime nga ofrues të huaj.

Kjo qasje mund të jetë e justifikuar për ndërhyrje të rralla ose shumë të specializuara. Megjithatë, kornizat ndërkombëtare theksojnë se vendimet për blerje duhet të jenë të harmonizuara me objektivat afatgjata të zhvillimit të sistemit^(5,6).

Kur një pjesë e konsiderueshme e fondeve publike drejtohet jashtë vendit, lindin pyetje të rëndësishme lidhur me kostot oportune dhe prioritetet e investimit.

Financimi publik i trajtimit jashtë vendit duhet të vlerësohet në raport me:

- numrin vjetor të rasteve të financuara;

- pjesën e buxhetit shëndetësor të alokuar për kujdes ndërkufitar;
- gjendjet mjekësore më të referuara;
- transparencën dhe konsistencën e kritereve të përshtatshmërisë.

Pa monitorim sistematik dhe raportim transparent, financimi ndërkufitar rrezikon të bëhet reaktiv, dhe jo i planifikuar në mënyrë strategjike.

5.3 Kujdesi ndërkufitar i financiar privatisht

Përveç rasteve të financuara publikisht, shumë familje kërkojnë trajtim jashtë vendit duke përdorur mjete e tyre private. Këto shpenzime nuk pasqyrohen plotësisht në statistikat zyrtare, por përfaqësojnë një barrë të konsiderueshme financiare.

Nivelet e larta të pagesave jashtë xhepit brenda Kosovës^(1,11), të kombinuara me perceptimet për dallime në cilësi dhe kufizimet në shërbime, kontribuojnë në kërkesën për trajtim jashtë vendit.

Pacientët shpesh i drejtohen shërbimeve në vendet fqinje si Maqedonia e Veriut, Shqipëri, si dhe në Turqi dhe vende të tjera evropiane për ndërhyrje më komplekse.

Në shumicën e rasteve, këto shërbime financohen drejtpërdrejt nga familjet. Kjo krijon shqetësime të qarta për barazinë: qasja në kujdes të specializuar bëhet e varur nga kapaciteti financiar.

Familjet me më shumë të ardhura financiare janë në gjendje të anashkalojnë kufizimet e sistemit vendor, ndërsa familjet me të ardhura më të ulëta përballen me vonesa ose heqje dorë nga trajtimi. Prania e trajtimit jashtë vendit të financiar privatisht forcon kështu pabarazitë strukturore brenda sistemit të financimit të shëndetësisë.

Përveç kostove financiare, kujdesi ndërkufitar mund të sjellë edhe ngarkesa sociale dhe psikologjike, përfshirë ndarjen nga rrjetet mbështetëse, barrierat gjuhësore dhe pasigurinë gjatë trajtimit.

